

Albania

Bota e çudirave e fizkulturës për fëmijë

Të dielave ora 17-19

Botët e çudirave të fizkulturës për fëmijë janë pa pagesë dhe ato ftojnë fëmijët 1-12 vjeçarë të Turkut për të bërë qejf! Botët e çudirave ofrojnë mundësi për fizkulturë të shumëllojshme dhe për lojëra për tërë familjen. Aktiviteti është i mbikëqyrur mirëpo i pa udhëhequr, kështu që me fëmijën duhet të jetë edhe i rrituri / prindi.

Punkte të aktiviteteve gjenden rreth e përçark Turkut. Mirë se vini për të lëvizur!

Punktet e aktiviteteve, orari dhe orari në raste specifike: turku.fi/ihtmema

Të dhëna shtesë: tel. 050 554 6219

(Facebook-tunnus) Bota e çudirave e fizkulturës për fëmijë

Grupet e fizkulturës aplikative për fëmijë dhe të rinj

Në javët 36-49 dhe 2-18

Grupet janë të parapara për fëmijë dhe të rinj të cilët kanë nevojë për mbështetje të posaçme në fizkulturë, të cilët kërkojnë një hobi komod për vete. Për çdo javë ofrohen grupe të shumta të ndryshme të fizkulturës, në të cilat mund të përjetohen lumturia dhe gëzimi nga fizkultura. Eja bashkë me ne të kërcejmë, të vallëzojmë, të lozim dhe të notojmë!

Të dhëna shtesë: turku.fi/soveltavaliikunta -> lasten soveltavan liikunnan ryhmät kausiesite.

Ushtrë hobi të gjatë kohës në shkollë

Shkathtësi themelore të fizkulturës dhe ushtrime të shumëllojshme brenda dhe jashtë!
Aktivitete të lira pa pagesë organizohen gjatë ditëve të shkollës në javët 36-49 dhe 2-18 (jo gjatë javëve të pushimeve shkollore). Pyesni rreth hobive / aktiviteteve të lira, përgjegjësin e klubit ose mësuesin e fëmijës tuaj.

Hobit që mund të ushtrohen në shkollë të caktuara gjenden të grumbulluara në:

turku.fi/harrastelukkarit

MIHI

Në javët 36-49 dhe 2-18 (jo në javën 8).

MIHI ofron mbi 40 radhë të disiplinave të ndryshme të fizkulturës pa pagesë në Turku për të rinjtë 12-19 vjeçarë. Ka mundësi të shumëllojshme të disiplinave individuale si dhe ekipore. Përpos atyre disiplinave mund të shkoni privatisht edhe për të rrëshqitur në qilimin e rrëshqitjes dhe për të vrapuar me ski në Impivaara (pajisjet pa pagesë). Të rinjtë kanë mundësi gjithashtu që të rezervojnë terminë për të lozur në salla të shkollave të Turkut. Në terminët MIHI nuk ka nevojë të lajmërohesh paraprakisht (përpos për bilardo dhe për lojërat me laser).

Të dhëna shtesë: jorma.fisk@turku.fi ose tel. 050 554 6250

Shihni: mihi.fi

Aktiviteti kërkimor për hobi në shkollë

Në shumë shkollë fillore të Turkut organizohen aktivitete për të kërkuar hobi. Ky shërbim është i paraparë për nxënësit e shkollave pjesëmarrëse, të cilët akoma nuk kanë gjetur për vete ndonjë aktivitet të lirë që u pëlqen. Koordinator i aktivitetit kërkimor për hobi i shkollës tuaj ndihmon dhe këshillon nxënësit për të gjetur hobi që u pëlqen atyre.

Të dhëna shtesë: turku.fi/koulujen-etsiva-harrastustoiminta

Pushime të këndshme nëpër lagje

Ky aktivitet është i destinuar për fëmijët e klasave të poshtme të shkollës fillore, veprimtari të ndryshme të këndshme, pa pagesë dhe të shumëllojshme gjatë kohës së pushimeve shkollore në verë, vjeshtë dhe në dimër. Veprimtaria organizohet nëpër pjesë të ndryshme të Turkut.

Lexo më shumë në adresën turku.fi/kivaloma ose në Facebook Kivaloma.